VENDIM
Nr. 536, datë 12.8.2024

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2024, MIRATUAR PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT, PËR SHPËRBLIMIN E SPORTISTËVE FITUES TË MEDALJEVE OLIMPIKE DHE ME REZULTATE TË LARTA, SI DHE TË TRAJNERËVE TË TYRE, PJESËMARRËS NË LOJËRAT OLIMPIKE "PARIS 2024"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në buxhetin e miratuar për vitin 2024, në zërin "Shpenzime korrente", llogaria ekonomike 604, "Të tjera transferta korrente të brendshme", të programit buxhetor "Për zhvillimin e sportit", i shtohet fondi prej 14 700 000 (katërmbëdhjetë milionë e shtatëqind mijë) lekësh për shpërblimin e sportistëve fitues të medaljeve olimpike dhe me rezultate të larta, si dhe të trajnerëve të tyre, pjesëmarrës në Lojërat Olimpike "Paris 2024".
2. Efekti financiar, prej 14 700 000 (katërmbëdhjetë milionë e shtatëqind mijë) lekësh, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2024.
3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama